REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 308/2 prot. Tiranë, më 08.06.2023

VENDIM

Nr. 990, Datë 08.06.2023

"MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT "MBI UDHËZIMET JOZYRTARE PËR SA I PËRKET ÇËSHTJEVE TË REJA OSE TË PAZGJIDHURA NË LIDHJE ME NENET 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 "PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS" PËR RASTE INDIVIDUALE""

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.06.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale".

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Udhëzimit "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale",

VËREN SE :

1. Qëllimi i Udhëzimit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale, është ofrimi i sigurisë ndaj ndërmarrjeve mbi ligjshmërinë e veprimeve të tyre në lidhje me një marrëveshje ose praktikë që duan të zbatojnë, në rast paqartësie, sepse ato prezantojnë pyetje të reja ose të pazgjidhura për zbatimin e neneve 4 ose 9 të ligjit nr. 9121/2003.

2. Udhëzimi parashikon se Autoriteti mund të ofrojë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet nëse është në përputhje me prioritetet e tij të zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës. Ai përcakton elementët të cilët do të merren në konsideratë për të vlerësuar nëse Autoriteti ka arsye të vlefshme për të dhënë qartësime mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të ligjit për marrëveshjen ose praktikën në fjalë, gjithashtu dhe rrethanat në të cilat Autoriteti nuk do të shqyrtojë një kërkesë për një letër udhëzuese.

3. Në Udhëzim sqarohen kushtet që duhet të përmbushë kërkesa e paraqitur nga një ndërmarrje ose disa ndërmarrje që kanë lidhur ose synojnë të hyjnë në një marrëveshje ose praktikë që mund të përfshihet në objektin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, në mënyrë që të merret në shqyrtim nga Autoriteti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

I. Miratimin e Udhëzimit "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA	**Rezana KONOMI**	**Adriana BERBERI**	**Durim KRAJA**
( )	( )	( )	( )
Zv/Kryetar	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**

Denar BIBA

( )

Kryetar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCËS

UDHËZIM

"Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale"

I. LIGJI NR. 9121, DATË 28.07.2003 "PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS"

1. Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" ka në fokus zbatimin efektiv të rregullave të konkurrencës. Ai krijon siguri juridike duke parashikuar që marrëveshjet që bien në nenin 4, por që përmbushin kushtet e nenit 5, janë të vlefshme dhe plotësisht të zbatueshme me vendim të Komisionit të Konkurrencës.

2. Ndërmarrjet janë në përgjithësi në pozitë të mirë për të vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve të tyre në mënyrë që të marrin një vendim të informuar nëse do të vazhdojnë me një marrëveshje ose praktikë të ndaluar dhe në cilën formë do ta bëjnë atë. Ato janë pranë fakteve dhe kanë në dispozicion kuadrin e rregulloreve të përjashtimit në bllok, praktikën gjyqësore dhe vendimet ekzistuese të Komisionit të Konkurrencës, si dhe udhëzime dhe rregullore të Komisionit, të cilat janë dhënë për të ndihmuar më tej vetëvlerësimin nga ndërmarrjet. Komisioni gjithashtu ka miratuar akte nënligjore në zbatim të nenit 6 të Ligjit nr. 9121/2003. Kjo u lejon ndërmarrjeve në shumicën e rasteve të vlerësojnë me besueshmëri marrëveshjet e tyre në lidhje me nenin 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

3. Në raste kur, pavarësisht elementeve të mësipërme, ndodhin realisht raste paqartësie, sepse ato prezantojnë pyetje të reja ose të pazgjidhura për zbatimin e neneve 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrjet mund të kërkojnë individualisht udhëzime jozyrtare nga Autoriteti i Konkurrencës. Në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë Udhëzim, një kërkesë nuk do t'i japë të drejtë kërkuesit për t'u udhëzuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Megjithatë, kur e konsideron të përshtatshme dhe në varësi të prioriteteve të tij të zbatimit, Autoriteti mund të japë një udhëzim jozyrtar në lidhje me interpretimin e neneve 4 ose 9 në një deklaratë me shkrim (letër udhëzuese). Në vijim përcaktohen detajet e këtij udhëzimi.

II. KORNIZË PËR VLERËSIM NËSE DUHET LËSHUAR NJË LETËR UDHËZIMI

4. Ligji nr. 9121/2003 i jep Autoritetit të Konkurrencës fuqi për të hetuar shkeljet e nenit 4 dhe 9, dhe për të vendosur gjoba. Një objektiv kryesor i Ligjit nr. 9121/2003 është të sigurojë zbatim efikas të rregullave të konkurrencës në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur një sistem vetëvlerësimi nga ndërmarrjet përpara njoftimit në Autoritet, duke lejuar Autoritetin të përqendrojë politikën e tij për zbatimin e nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

5. Megjithëse ligji nr. 9121/2003 nuk pengon Autoritetin e Konkurrencës për të dhënë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet, siç është përcaktuar në këtë Udhëzim, kjo nuk duhet të pengojë objektivin kryesor të Ligjit nr. 9121/2003, që është të sigurojë zbatim efektiv të nenit 4 dhe 9. Prandaj, Autoriteti mund të ofrojë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet nëse është në përputhje me prioritetet e tij të zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës.

6. Autoriteti, në rast se merr një kërkesë për një letër udhëzuese, do të shqyrtojë nëse është e përshtatshme t'a procesojë atë. Lëshimi i një letre udhëzuese mund të merret në konsideratë vetëm nëse Autoriteti, pas një vlerësimi prima facie të fakteve dhe konsideratave ligjore të sjelljes ose sjelljes të parashikuar, ka arsye të vlefshme për të dhënë qartësime mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të Ligjit për marrëveshjen ose praktikën në fjalë përmes një letre udhëzuese. Një vlerësim i tillë do të bazohet në dy elementët e mëposhtëm kumulativë:

   (a) Pyetje të pazgjidhura ose të reja: Vlerësimi substancial i marrëveshjes ose praktikës në lidhje me nenet 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 shtron një pyetje për të cilën nuk ka mjaftueshëm qartësi në kuadrin ligjor aktual, në praktikën e vendimmarrjes të Komisionit të Konkurrencës ose në letrat udhëzuese të mëparshme;

   (b) Interes në dhënien e udhëzimeve: Vlerësimi prima facie i marrëveshjes ose praktikës sugjeron se një sqarim mbi zbatueshmërinë e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 përmes një letre udhëzuese do të ishte një vlerë e shtuar në lidhje me sigurinë ligjore, duke marrë parasysh një ose më shumë nga elementët e mëposhtëm:

      - rëndësia aktuale ose potenciale ekonomike e mallrave ose shërbimeve të prekura nga marrëveshja ose praktika, veçanërisht duke marrë parasysh interesat e konsumatorëve;
      - nëse objektivat e marrëveshjes ose praktikës janë të rëndësishme për arritjen e prioriteteve të Autoritetit të Konkurrencës;
      - madhësia e investimeve të bëra ose të planifikuara nga ndërmarrjet, të lidhura me marrëveshjen ose praktikën.

7. Autoriteti nuk do të shqyrtojë një kërkesë për një letër udhëzuese në asnjërën nga rrethanat e mëposhtme:

   - pyetjet e ngritura në kërkesë janë të njëjta ose të ngjashme me çështje të ngritura në një rast në pritje përpara gjykatës; ose
   - marrëveshja ose praktika në të cilën kërkesa referohet është nën hetim nga Autoriteti i Konkurrencës.

8. Autoriteti nuk do shqyrtojë pyetje dhe nuk do të lëshojë letra udhëzuese në lidhje me marrëveshje ose praktikat që nuk po zbatohen më nga palët. Megjithatë, ndërmarrjet mund të paraqesin një kërkesë për një letër udhëzuese pranë Autoritetit në lidhje me pyetje mbi

një marrëveshje ose praktikë që ato parashikojnë, para zbatimit të kësaj marrëveshjeje ose praktike. Në këtë rast, planifikimi i marrëveshjes ose praktikës duhet të ketë arritur një fazë mjaft të përparuar që kjo kërkesë të shqyrtohet.

III. TË DHËNA PËR KËRKIMIN E UDHËZIMIT

9. Një kërkesë mund të paraqitet nga një ndërmarrje ose disa ndërmarrje që kanë lidhur ose synojnë të hyjnë në një marrëveshje ose praktikë që mund të përfshihet në objektin e neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

10. Një kërkesë për një letër udhëzuese duhet të drejtohet në adresën e mëposhtme:

    Autoriteti i Konkurrencës
    Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV
    Tiranë, 1004

    Ose në adresën e email: competition@caa.gov.al

11. Në kërkesën për letër udhëzuese, kërkuesi duhet të përfshijë:
    - të dhënat e të gjitha ndërmarrjeve në fjalë si dhe një adresë të vetme për kontaktet me Autoritetin;
    - pyetjet specifike mbi të cilat kërkohet udhëzimi jozyrtar;
    - informacion të plotë dhe shterues për të gjitha pikat e rëndësishme për një vlerësim të pyetjeve të ngritura, duke përfshirë dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të lejojë Autoritetin të lëshojë një letër udhëzuese;
    - vlerësimin paraprak të vetë kërkuesit(ve), duke pasur parasysh pikën 6(a) të këtij Udhëzimi, se përse kërkesa paraqet pyetje(a) të reja ose të pazgjidhura në funksion të kuadrit ligjor ekzistues të Republikës së Shqipërisë, të praktikës vendimmarrëse të Komisionit ose letrat e mëparshme udhëzuese;
    - vlerësimi paraprak i vetë kërkuesit(ve), duke pasur parasysh elementët e renditur në pikën 6(b) të këtij Udhëzimi, se përse një sqarim publik i zbatueshmërisë së neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 nëpërmjet një letre udhëzuese do të kishte vlerë të shtuar në lidhje me sigurinë juridike;
    - vlerësimin paraprak të kërkuesit(ve), sipas aftësive të tij (të tyre), të zbatimit të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 për çështjet e reja ose të pazgjidhura të ngritura nga marrëveshja ose praktika;
    - të gjitha informacionet e tjera që lejojnë një vlerësim të kërkesës në zbatim të pikave 7-8 të këtij Udhëzimi, duke përfshirë në veçanti një deklaratë që, sipas njohurive të kërkuesit(ve), marrëveshja ose praktika të cilës i referohet kërkesa nuk i nënshtrohet procedurave në pritje përpara një gjykate.
    - kur kërkesa përmban elemente që konsiderohen si sekrete tregtare, një identifikim i qartë i këtyre elementeve;

- çdo informacion ose dokumentacion tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e marrëveshjes ose praktikës.

12. Përpara dorëzimit zyrtar të kërkesës për një letër udhëzuese, ndërmarrja(et) mund të kontaktojë Autoritetin e Konkurrencës, për të diskutuar paraqitjen e tyre në mënyrë jozyrtare dhe konfidenciale.

IV. SHQYRTIMI I KËRKESËS

13. Autoriteti do të vlerësojë në parim kërkesën në bazë të informacionit të dhënë dhe nuk do të trajtojë kërkesa që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 11 të këtij Udhëzimi. Megjithatë, Autoriteti mund të përdorë informacion shtesë që ka në dispozicion nga burime publike, praktika të mëparshme vendimmarrëse apo çdo burim tjetër dhe mund të kërkojë nga kerkuesi(t) ose, në raste të jashtëzakonshme, nga palët e zgjedhura të japin informacione shtesë, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të dhënë nga kerkuesi(t). Kur ky informacion përmban të dhëna personale, Autoriteti i përpunon të dhënat personale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

14. Autoriteti mund të ndajë informacionin e dorëzuar me autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare dhe të marrë vlerësime prej tyre. Ai mund të diskutojë me autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare për substancën e kërkesës përpara se të lëshojë një letër udhëzuese.

15. Duke iu referuar pikave 12-14 të këtij Udhëzimi, rregullat mbi ruajtjen e konfidencialitetit dhe e sekreteve tregtare të përcaktuara në nenin 30 të Ligjit nr. 9121/2003 zbatohen për informacionin e dhënë nga kërkuesi(t) ose palët e treta të zgjedhura.

16. Autoriteti do të informojë kërkuesin për rrjedhën e veprimeve që ai ka në plan të ndërmarrë në lidhje me kërkesën për udhëzim brenda një kohe të arsyeshme, duke u bazuar në rrethanat e secilit rast. Në rast se nuk lëshohet një letër udhëzuese, Autoriteti do të informojë kërkuesi(n) për këtë me shkrim.

17. Kërkuesi(t) mund të tërheqë kërkesën e tij/saj në çdo moment. Në raste të tilla, nuk do të lëshohet asnjë letër udhëzuese. Megjithatë, informacioni i dhënë në kontekstin e një kërkese për udhëzim jozyrtar mbetet i disponueshëm për Autoritetin dhe mund të përdoret për të nisur procedura të mëtejshme sipas Ligjit nr. 9121/2003.

18. Kërkesa për një letër udhëzuese nuk cënon kompetencën e Autoritetin për të hapur procedura hetimore në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 në lidhje me faktet e paraqitura në kërkesë.

V. LETRA UDHËZUESE

19. Një letër udhëzuese e lëshuar nga Autoriteti përmban:

- një përshkrim të përgjithshëm të fakteve në të cilat bazohet;
- vlerësimin ligjor të Autoritetit mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003 mbi pyetjet e reja ose të pazgjidhura që ngrihen nga marrëveshja ose praktika.

20. Një letër udhëzuese mund t'u përgjigjet vetëm një pjesë të pyetjeve të ngritura, ose mund të përfshijë aspekte shtesë nga ato që janë përcaktuar në kërkesë. Nëse është e nevojshme, Autoriteti mund të përcaktojë në një letër udhëzuese një afat kohor për zbatimin e saj ose të specifikojë se letra udhëzuese është e bazuar në ekzistencën ose mungesën e rrethanave të caktuara faktike.

21. Letrat udhëzuese do të publikohen në faqen e internetit të Autoritetit, duke marrë parasysh mbrojtjen e sekreteve tregtare të kërkuesit(ve). Autoriteti do të bjerë dakord me kërkuesin (it) për një version publik përpara publikimit të letrës udhëzuese.

VI. EFEKTET E LETRAVE UDHËZUESE

22. Letrat udhëzuese synojnë në radhë të parë të ndihmojnë ndërmarrjet të kryejnë një vetëvlerësim të informuar të marrëveshjeve apo praktikave. Në këtë aspekt, kërkuesi(t) mbetet(n) përgjegjës për të kryer vetëvlerësimin e tyre për zbatueshmërinë e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Letrat udhëzuese reflektojnë pikëpamjet e Autoritetit mbi faktet e paraqitura dhe nuk krijojnë asnjë të drejtë apo detyrim për kërkuesin(t) ose për ndonjë palë të tretë.

23. Një letër udhëzuese nuk mund të paragjykojë vlerësimin e së njëjtës pyetje nga gjykata.

24. Në atë rast, Autoriteti do të marrë parasysh letrën e mëparshme udhëzuese, në veçanti në varësi të ndryshimeve në faktet themelore, të çdo aspekti të ri të zbuluar nga Autoriteti ose të ngritur nga një ankesë, ndaj zhvillimeve në praktikën gjyqësore ose ndryshime më të gjera të politikës në tregjet përkatëse. Në parim dhe në varësi të pikës 26 të këtij Njoftimi, Autoriteti nuk do të vendosë asnjë gjobë ndaj aplikantit(ve), në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë nga aplikanti(ët) duke u mbështetur në mirëbesim në letrën udhëzuese të Autoritetit. Aty ku e kërkon interesi publik, Autoriteti mund të modifikojë ose revokojë një letër udhëzuese në përputhje me rrethanat, me vendim të Komisionit të Konkurrencës.

25. Sqarimet mbi zbatueshmërinë e nenit 4 ose 9 të Ligjit nr. 9121/2003, të përfshira në një letër udhëzuese, kushtëzohen shprehimisht nga saktësia dhe vërtetësia e informacionit të

dhënë nga kërkuesi(t) dhe çdo ndryshim substancial i informacionit të dhënë nga kërkuesi(t) e bëjnë letrën udhëzuese të pavlefshme.

26. Letrat udhëzuese nuk janë vendime të Komisionit dhe nuk detyrojnë gjykatat të marrin në konsideratë një letër udhëzuese të lëshuar nga Autoriteti i Konkurrencës, në kontekstin e një rasti.